



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. **61**

Prishtinë, më 21.12.2009, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Hestet Cakolli, Berat Luzha, Selvie Halimi, Elheme Hetemi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Zulfi Merxha, Zef morina.

Mungoi : Dragiša Mirić.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : anëtarët e Komisionit për komunitete, zyrtar të MMPH, përfaqësues ndërkombëtar dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku .

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Projektligji për Shitjen e banesave,
3. Të ndryshme.

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e rendit të ditës.

**1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**

**Naser Rugova-kryetar** konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**2. Shqyrtimi i projektligjit për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, bashkërisht me anëtarët e Komisionit për Komunitete**

**Kryetari Naser Rugova** në fillim dëshiroi mirëseardhje dhe falënderoj për pjesëmarrje duke sqaruar shkurtimisht arsyet e caktimit të mbledhjes së përbashkët. Ai tha se ky komision në cilësinë e komisionit funksional si dhe MMPH kanë obligime ligjore dhe kushtetuese për të marr njoftime dhe përgjigje zyrtare lidhur me projektligjet në fushën e tyre, sidomos për projektligjin për shitjen e banesave i cili është kategorizuar si sfidë e veçantë në raportin e komisionit evropian. Ai tha se ky komision nuk dëshiron prolongim të panevojshëm dhe

sinqerisht është i interesuar të përfundoj punën rreth projektligjit në fjalë, ai hapi debatin duke ja dhënë fjalën kryesuesit të GP për këtë projektligj në Komisionin për Komunitete z. **Numan Baliq**, i cili u pajtua me konstatimet e kryesuesit për prolongimin e projektligjit dhe shprehu interesimin që sa më parë të procedohet ky projektligj më tutje. Si kryesues i GP tha se nënkomisioni është formuar në korrik 2008 dhe deri tani janë hartuar amendamentet për nenet 6,7,13,14,20,22,23 dhe komplet për kreun III. Ai potencoi problemet e të drejtave të punësuarve, shtetasve të huaj (kush konsiderohet shtetas i huaj) dhe formulimi sa i përket banesave që janë me shitës të panjohur. Ky projektligj ka të bëjë me pronarët që kanë punuar në organizata shoqërore nga vitet 1990-1999, kanë marr banesa dhe kanë jetuar në Kosovë, Mal të Zi, Sanxhak etj. Gjithashtu çmimi shitës tek neni 19 nuk është mirë e rregulluar dhe kreu III. Ai propozoi të diskutohen amendamentet e gatshme dhe ti dërgohen komisionit funksional. Potencoi se kjo zhargitje nuk është për arsye se nuk dëshirohet ky ligj por ngecje për shkak të marrëveshjes së vonuar, si edhe problemeve të kryetarit aktual të komisionit i cili për shkak të obligimeve tjera (nuk është më kryetar i komisionit) ka kontribuar në prolongimin e projektligjit. ICO i ka tre versione, ndërsa komisioni (nënkomisioni) i ka amendamentet, ndaj propozoi që këto të janë bazë për vërejtje përfundimtare gjatë muajit janar 2010, mirëpo megjithatë shtoi se thelbi i problemit është që **disa nene (amendamente) në këtë grup punues asnjëherë nuk kanë pasur mbështetje për inkorporim në këtë projektligj, prandaj edhe ka mbetur situata ashtu si është momentale.**

**Naser Rugova** shprehu mirëkuptimin e komisionit funksional dhe kërkoi që vërejtjet e cekura të dërgohen zyrtarisht në këtë komision gjatë muajit janar në mënyrë që ky projekt të përfundoj në tremujorin e parë 2010, sepse një projektligj nuk mund të jetë peng i një individi (në këtë rast kryetarit etj). Ai vërejtji mosprezencën e komunitetit serb në takimin e sotëm, ndaj në këtë drejtim kërkoi angazhimin e komisionit për komunitete.

**Zylfi Merxha** tha se nuk është vendosë asgjë tetë muaj, ndaj shprehu bindjen se një pakicë po bllokoi këtë projektligj por komisioni është ai që vendos për më tutje.

**Sadik Idriz** u bashkëngjiti atyre që mendojnë se ky projekt ka probleme dhe nuk është mirë të miratohet kështu si është. Komisioni nuk ka pasur sukses deri tani në hartimin e amendamenteve për shkak të dilemave, ndaj më mirë është të prolongohet edhe pak sesa të shkoj më tutje kështu si është. Kujdesi duhet të jetë maksimal, ngase dikush do ta humb banesën.

**Nexhat Shatri** nga presidenca tha se ky projektligj është specifik dhe është hartuar për ish Jugosllavinë ngase asnjë shtet në rajon dhe më gjerë nuk kanë pasur diçka të tillë. Ai sqaroi se para vitit 1999 banesat janë blerë nga të ardhurat personale të punëtorëve pastaj janë dhënë punëtorëve, më tutje është hartuar kontrata për shfrytëzimin e banesës. Ai kategorikisht mohoi ekzistimin e shitësit të panjohur (apo pronarit të panjohur) ngase dokumentacioni ekziston tek ish BVI-ja për Banesa, sipas rregullës së cilës nëse nuk dihet pronari ato banesa i shkojnë Komunës. Vitet 1990-1999 kanë qenë të vështira për shqiptarët ngase ka ardhë p.sh. një person nga Kragujevci dhe ka fitua prioritet për drejtën e banesës dmth shqiptarëve iu është grabit drejta banesore. Shqiptarëve (të cilët janë ndjekur politikisht) ju është deshtë të marrin pëlqimin nga ministria serbe.

**Xhevat Azemi** nga APK tha se prolongimi i projektligjit në fjalë ka ardhë edhe si shkak moskoordinimit të takimeve institucionale, përndryshe ai mendon se konstatimi për cenimin e drejtave të komuniteteve me këtë projektligj është i gabuar, ngase ky projekt ka zanafillën nga viti 2004-5 sipas standardit të VI. Në fakt gjatë vitit 1992 është nxjerr ligji serb për banimin me aplikim edhe në Kosovë me të cilin pjesa dërmuese e banesave janë privatizuar por megjithatë kanë mbetur kategoria e shumicës shqiptare të larguar nga puna të cilët nuk kanë pasur mundësi të sjellin pëlqimin nga ministria përkatëse serbe. Mirëpo me këtë ligj synohet që të blihen banesat nga personat që kanë drejtë banesore, dmth ai nuk e sheh mundësinë e humbjes së banesës me këtë ligj, dhe shprehu mendimin se kufizimi i cekur 24 qershor 1999 tanimë nuk ekziston pas ndërhyrjeve (pakicat kanë drojën se prej dy personave

që kanë dokumentacionin për privatizim do të humb ai që i takon pakicës). Për çmimin tha se është real (nuk është i ulët). Ai shprehu gatishmërinë për të kontribuar në komision.

**Naser Rugova** inkurajoi të gjithë të kontribuojnë duke dorëzuar vërejtjet me shkrim.

**Mursel Halili** pyeti për fatin e banesave të YU programit të cilat janë prezentë gadi në çdo qytet të Kosovës.

**Sanije Alijaj** kërkoi falje për vonesë dhe u bashkëngjiti me mendimin se për këtë projektligj mbi 4 herë është munduar të harmonizohen qëndrimet por pa sukses, me ç'rast është formuar nëngrupi punues. Ajo ishte kategorike se asnjëherë nuk janë thënë arsyt pse shkelen drejtat e komuniteteve me këtë projektligj, ndaj në mbledhjen e fundit është kërkuar që muaji janar të jetë përfundimtarë lidhur me këtë projekt, falënderoj për propozime.

**Bardha Krasniqi (ICO)** kërkoi dokumentacionin përkatës lidhur me projektligjin, ngase nuk i kanë ato.

**Naser Rugova** tha se kjo kërkesë ka të bëjë me aspektin teknik të problemeve të stafit të të dy komisioneve dhe kërkoi angazhimin e stafit në këtë drejtim.

**Hetem Arifi** tha se askush nuk prolongon pa ndonjë arsye, por parashtrori pyetjen pse amendamentet e nënkomisionit nga dt. 29.7.2009 nuk janë miratua. Ai ishte i mendimit se një angazhim fare e vogël do ti eliminoi problemet e cekura në këtë takim.

**Sanije Alijaj** ndërhyri dhe shtoi se kryetari aktual i komisionit ka organizuar një takim me përfaqësuesit ndërkombëtar me ç'rast kjo çështje (ky projekt) ka fituar konotacion politik, përndryshe kategorikisht mohoi se dikush nga komisioni prolongon këtë projektligj dmth kemi të bëjmë me pengesë brenda për brenda. Ajo shprehu mendimin se shpejt do të jetësohet përfundimi i shqyrtimit të këtij projektligji.

**Kryetari Naser Rugova** nxori këtë :

### **KONKLUDIM TË PËRBASHKËT**

**Komisioni për Drejtat dhe interesat e Komuniteteve dhe kthim të mblidhet pas 15 janarit 2010 me të gjithë mekanizmat e interesuar dhe grupin punues në mbledhjen e vet, dhe zyrtarisht me shkrim të dërgoi deri në fillim të muajit shkurt vërejtjet në projektligjin për Shitjen e Banesave në të cilat ekziston e drejta banesore komisionit funksional si dhe sugjerimet për amendamentet e komisionit funksional.**

**Zef Morina, anëtarë i komisionit funksional, preferohet të bashkëpunoi nëse ka nevojë me komisionin për komunitete rreth përfundimit të shqyrtimit të projektligjit në fjalë.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,10. Mbledhja e radhës do të mbahet pas pushimeve të fundvitit.

Kryetari i Komisionit,  
**Naser Rugova**